

DEKLARATË E ECMI-SË MBI INCIDENTIN TRAGJIK NË FUSHË KOSOVË QË PËRFSHIN NJË FËMIJË ROM DHE THIRRJE PËR MASA URGJENTE PËR TË ADRESUAR ÇËSHTJET E PAPUNËSISË DHE VARFËRISË SË PËRHAPUR NË MESIN E KOMUNITETEVE ROMË, ASHKALI, DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË

19 dhjetor 2014

Më 18 dhjetor, një fëmijë 7 vjeçar në Fushë Kosovë u sulmua brutalisht nga disa qenë endacakë dhe më pas vdiq si pasojë e lëndimeve të shkaktuara. Fëmija—një banor i Fushë Kosovës i etnisë rome me inicialet D.J.—sipas deklaratave të dhëna nga anëtarët e familjes, ishte në kërkim të ushqimit nëpër kontejnerët e mbeturinave kur ishte sulmuar nga qentë endacakë. ECMI Kosova është thellësisht e pikëlluar me këtë ngjarje dhe dëshiron të i shpreh ngushëllimet e veta familjes së fëmijës. Incidenti, sidoqoftë, zbulon një problematikë më të madhe të çështjeve të pazgjidhura të papunësisë dhe varfërisë së gjithanshme që është e përhapur në mesin e komuniteteve romë, ashkali, dhe egjiptian në Kosovë. Incidenti ndodhi në afërsi të kontejnerëve të mbeturinave në Fushë Kosovë ku D.J., sipas deklaratave të familjes së tij, ishte në kërkim të ushqimit. Skena të ngjashme janë të zakonshme në të gjithë Kosovën dhe ato nënvizojnë pozitën e pafavorshme të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në shoqërinë kosovare, duke detyruar një numër të tyre të kërkojnë ushqim ose gjëra me vlerë në kontejnerë të mbeturinave, shpesh në kushte shumë të rënda.

Kjo ngjarje tragjike tregon për një problem serioz me qentë endacakë në tërë Kosovën, siç dëshmohet nga numri në rritje i incidenteve me qentë endacakë. Incidente të kësaj natyre kanë ndodhur edhe në të kaluarën në pjesë tjera të Kosovës (si për shembull më 19 mars 2009 në Kamenicë kur qentë endacak sulmuan një fëmijë, E.F., ndërsa ai shkonte në shkollë, me pasojë vdekjen e tij tragjike). ECMI Kosova gjithashtu dëshiron të shpreh shqetësimin e saj dhe të

nënvizojë faktin që incidentet si këto janë tërësisht të shmangshme, dhe të i bëjë thirrje autoriteteve komunale dhe qendrore që të merren me problemin në rritje të qenve endacakë.¹

Vdekja tragjike e D.J. risjell në vëmendjen tonë faktin se ekziston një nevojë urgjente për të i adresuar çështjet që prekin këto tri komunitete; kryesoret në mesin e atyre çështjeve janë papunësia e lartë, kushtet e rënda ekonomike dhe mungesa e integritit dhe marginalizimi i komuniteteve. ECMI Kosova ka shkruar më parë në lidhje me kushtet e rënda ekonomike dhe sociale si dhe me sfidat në integrim me të cilat ballafaqohen këto tri komunitete posaçërisht të cenueshme të Kosovës në raportin e dhjetorit të vitit 2014 *Sfidat në procesin e integritit në Kosovë: Emigrimi në rritje i romëve, ashkalinjëve, dhe egjiptasëve*.

Për të lexuar më shumë mbi zhvillimet politike ju lutem shihni përditësimet dhe analizat tona të fundit politike:

- *Sfidat në procesin e emigrimit në Kosovë: Emigrimi në rritje i romëve, ashkalinjëve, dhe egjiptasëve*
<http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/12/Albanian.pdf>
- *Përmbledhje politike: Qeveria e re, përfaqësimi i komuniteteve, dhe sfidat në të ardhmen*
<http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/12/Albanian2.pdf>
- *Përngjitja e ndarjes: Themelimi i një bordi të përbashkët për qytetin e Mitrovicës*
<http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/06/Policy-Brief-Joint-Board-Final-shqip.pdf>
- *Përmbledhje e shkurtër e zhvillimeve politike nga ana e ECMI Kosovës: Komunitet pakicë dëshirojnë të shohin fundin e ngërçit politik* - <http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/10/Albanian1.pdf>
- *Një vështrim i shkurtër mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë* - <http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/11/Albanian.pdf>
- *Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një shikim i çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit* - <http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/06/Information-Bulletin-Minority-Party-Elections-SQ.pdf>

¹ Nga ana e tyre, autoritetet komunale kanë theksuar se ligjet e zbatueshme në Kosovë nuk i lejojnë ata që të i "eliminonjë" qentë, dhe se ata që kanë bërë çdo gjë në fuqinë e tyre duke kastruar qentë. Për më shumë, ju lutem shihni këtu <http://koha.net/?id=3&l=37530>.



EUROPEAN CENTRE FOR MINORITY ISSUES KOSOVO

- *Një Përmbledhje e disa prej ndryshimeve në Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës* - <http://www.ecmikosovo.org/?p=4735> (Anglisht)
- *Drejtësia në tranzicion, të drejtat e pakicave, komunitetet në Kosovë* (Anglisht) <http://www.ecmikosovo.org/?p=4676>
- *Promovimi i Fuqizimit Ekonomik të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase në Kosovë* http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2013/12/FINAL-REPORT_ALB.pdf
- *Gjetjet e vlerësimit për komunitetet dhe kthimin 2009-2013* http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/07/ALB_ECMI-Findings-of-the-Assessment-of-Communities-and>Returns-2009-2013_FINAL_ALB.pdf
- *Ofrimi i arsimit për komunitetet Rom, Ashkanli dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës* http://www.ecmikosovo.org/wp-content/Publications/Reports_and_studies/2012-10_ECMI_Kosovo_Baseline_Study_Delivery_of_Education_to_Roma_Ashkali_and_Egyptian_Communities_in_Fushe_KosoveKosovo_Polje/alb.pdf
- *Segregacioni në arsim në Komunën e Gjakovës* http://www.ecmikosovo.org/wp-content/Publications/Press_releases_and_information_bulletin/2013-01_ECMI_Kosovo_Information_Bulletin_Segregation_in_Education_in_Gjakova/alb.pdf

Rreth ECMI Kosova

ECMI Kosovo është organizatë kryesore jo-qeveritare e angazhuar me qështjet e minoriteteve në Kosovë, që qëllim kryesor ka zhvillimin e institucioneve gjithpërfshirëse, përfaqësuese, dhe të ndieshme ndaj komuniteteve dhe që përkrahin një Kosovë multi etnike dhe stabile. ECMI Kosovo kontribuon për zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacioneve relevante, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe përmirësimin e kapaciteteve të akterëve të shoqërisë civile dhe qeverisë për t'u ndërlidhur me njëri tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme



EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

Str. Nëna Terezë Nr. 41, Apt. 29, 10000 Prishtinë/Priština, Kosovo, Tel. +381 (0) 38 224 473
Str. Cika Jovina Nr. 3, 1st Fl, 38220 Mitrovica/Mitrovicë North, Kosovo, Tel. +381 (0) 64 00 55 488

www.ecmikosovo.org, info@ecmikosovo.org  